VENDIM EKSTRAKT

Për kriterin e pranueshmërisë nenin 120 pika 1, shkronja d) e dh) (për veprimtari prokurori dhe gjyqtari)

Ankuesi i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me disa ankesa, në të cilat ngre pretendime lidhur me veprimtarinë ndaj një prokurori dhe një gjyqtari, përkatësisht, pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ankesat janë bashkuar për shqyrtim, pasi lidhen me të njëjtat fakte dhe u drejtohen të njëjtëve magjistratë.

Ankuesi kundërshton kërkesën e organit të prokurorisë për konfiskimin e një pasurie të paluajtshme si dhe vendimmarrjen e gjykatës që ka pranuar kërkesën për konfiskim. Ankuesi pretendon se veprimet e prokurorisë dhe vendimi i gjykatës janë marrë në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu ai kërkon përgënjeshtrimin e një lajmi të publikuar në media lidhur me vendimin administrativ penal nr. 11, të viti 2020, me pretendimin se ky vendim nuk ka marrë formë të prerë.

Nga shqyrtimi fillestar i ankesave, referuar kritereve për pranueshmërinë e saj të parashikuara nga neni 120 i ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", rezulton se ankesat janë paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120, pika 1, shkronja "a" të këtij ligji, pasi përmbajnë gjeneralitetet e ankuesit dhe adresën e tij, përshkruajnë rrethanat e faktit që pretendohen të kenë ndodhur, si dhe përmbajnë emrin dhe mbiemrin e magjistratëve, si dhe gjykatën dhe prokurorinë pranë së cilës këta magjistratë kanë ushtruar funksionin në kohën kur pretendohet shkelja e kryer.

Nga përmbajtja e ankesës dhe nga informacioni i marrë në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve konstatohet se pretendimet e ngritura u referohen fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit. Për rrjedhojë ankesat plotësojnë kriterin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, pasi janë paraqitur brenda afatit 5-vjeçar të parashkrimit.

Sa i përket pretendimeve ndaj prokurorit, vlerësohet se paraqitja e kërkesës për konfiskimin e pasurisë përbën ushtrim të funksioneve të tij ligjore në kuadër të ndjekjes penale. Ligjshmëria e veprimeve të prokurorit si dhe vlerësimi i fakteve, provave dhe ligjit të zbatueshëm, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor. Në rastin konkret, kërkesa e prokurorit është shqyrtuar nga gjykata, e cila e ka pranuar atë.

Nga shqyrtimi fillestar i ankesave nuk janë evidentuar elementë juridik apo faktik që të krijojë dyshim të arsyeshëm për fillimin e hetimit disiplinor ndaj këtij magjistrati. Sikurse rezulton nga verifikimi i kryer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve pranë kësaj gjykate është regjistruar kërkesa penale me objekt "Konfiskimin e pasurisë së sekuestruar të shtetasit X", e paraqitur nga prokurori dhe në përfundim të gjykimit me vendimin datë 23.06.2025, gjyqtari i çështjes ka vendosur pranimin e kërkesës dhe konfiskimin e pasurisë së sekuestruar.

Lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi ndaj gjyqtarit se vendimi është dhënë në shkelje të ligjit, vlerësohet se ato janë pretendime që kanë të bëjnë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes

gjyqësore, vlerësimin e provave nga gjykata respektive. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor dhe interpretimi i ligjit sipas bindjes së brendshme në gjykimin e një çështjeje është atribut i pushtetit gjyqësor. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të zëvendësojë gjykata në ushtrimin e funksionit të tyre gjyqësor. Përjashtimisht, përgjegjësia disiplinore mund të ushtrohet ku ka indicie për sjellje të magjistratit që përbëjnë shkelje disiplinore, por në rastin konkret nuk janë konstatuar indicie të tilla.

Për rrjedhojë lidhur me pretendimet ndaj magjistratëve, ankesat nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë të parashtruara në nenin 120, pika 1, shkronja "d" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi nga shqyrtimi fillestar nuk rezultojnë elementë që të krijojnë dyshime të arsyeshme për kryerjen e shkeljeve disiplinore të pretenduara.

Ndërsa, për sa i përket kërkesës së ankuesit për përgënjeshtrimin e lajmit të publikuar në media, lidhur me vendimin administrativ penal nr. 11, të vitit 2020, vlerësohet se kjo kërkesë nuk përfshihet në objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas nenit 194, pika 1, të ligjit nr. 115/2016 " Për organet e qeverisjes se sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe për këtë arsye nuk mund të trajtohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "d' dhe "dh" dhe nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenin 214 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

VENDOSA

- Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara nga ankuesi të regjistruara ndaj magjistratëve.
- Në zbatim të nenit 121, pika 3, të ligjit 96/2016, i ndryshuar ky vendim t'i njoftohet ankuesit dhe magjistratëve përkatës brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.
- Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 (një) jave nga marrja e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë